

VENDIM
Nr. 775, datë 15.12.2021

PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË SINJALEVE TË ALARMIT, NUMRIT DHE MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE NË RASTET E FATKEQËSIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre në rastet e fatkeqësive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Sinjalet e alarmit për njoftimin e hershëm të popullsisë, për marrjen e masave të menjëhershme, për mbrojtjen nga fatkeqësitë, të jenë të kuptueshme nga të gjitha kategoritë e popullsisë. Gjuha e përdorur të jetë e thjeshtë dhe të përdoren mesazhe me figura.

3. Sinjalet e alarmit ndahen në:

a) sinjale pamore, si më poshtë vijon:

i. tabela vertikale elektronike për dhënien e mesazheve të ndryshueshme alfanumerike me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme;

ii. tabela vertikale statike me figura dhe mesazhe paralajmëruese me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme;

iii. sinjale tymuese ose fluturuese;

b) sinjale zanore që jepen përmes:

i. sirenave statike ose të lëvizshme;

ii. sistemeve zanore të lëvizshme.

4. Sinjalet e alarmit transmetohen përmes:

a) rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme;

b) rrjeteve të shpërndarjes së përmbajtjeve audio dhe audiovizive, si:

i. rrjetet e operatorëve kombëtarë audio;

ii. rrjetet e operatorëve kombëtarë audiovizivë.

5. Në varësi të shtrirjes territoriale, sinjalet pamore të jenë jo më pak se një shenjë paralajmëruese për 1 000 banorë. Autoriteti përgjegjës për caktimin e vendeve, ku vendosen sinjalet e alarmit për ruajtjen dhe mbajtjen në gatishmëri, është prefekti i qarkut në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë.

6. Kohëzgjatja e përdorimit të sinjaleve të alarmit përkon me kohëzgjatjen e fatkeqësisë.

7. Institucionet publike dhe subjektet private, përgjegjëse për administrimin e sinjaleve të alarmit, vetëm ose në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sigurojnë trajnimin e personelit të tyre për mënyrën e përdorimit të sistemeve të alarmit.

8. Përdorimi i sinjaleve bëhet i kombinuar për informimin e të gjitha kategorive të popullsisë.

9. Efektet financiare të këtij vendimi të mbulohen nga buxheti i shtetit akorduar bashkive, brenda fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile.

10. Ngarkohen ministri përgjegjës për mbrojtjen civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ministritë e linjës, prefekti i qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj